

letrat që janë përhapur në tokë. Tjatër soj s'ka as më të pakëtin ndryshim nga konçina që lohet në qytetet.

Fëmija lozin me "dojka", e cila i përgjeth lojnës "rakadoçe" që lohet në Tiranë. Pra, përpara shtëpisë dhe në një vënt të hapët, njeriu munt të shohë fëmijët me shkopinj në duart t' i bien një cungu (copë druri të vogël), të cilin një tjatër fëmijë përpiket t' a futë në një gropë të vogël. Kjo duket se është një gjimnastikë e mirë për ta.

Luajnë edhe me "rras". Në këtë lodrë ndahen më dy parti edhe, dyke qënë ballë për ballë, rreshtohen më një largësi pothuajë pëdhjetë metrash. Në mes të tyre edhe për dhëvenë fiçorë të cilët i qëllojnë me gurrët që mbajnë në duart. Ajo parti që rëzon fiçorët më parë i hipën partisë kundrëshitare dhe kjo detyrohet t' i shpjerë që nga vëndi i tyre deri ke vëndi i fituësve. Kjo lodrë vazhdon gjër sa të lodhen të dy palët.

Munt të lozin "topthi" ose edhe me "kala" dhe besoj se nuk ndryshojnë nga lojnat që ndodhen edhe në vëndet e tjerë të Shqipërisë. Këto lohen prej të madhi dhe të vogli, më ç' do kohë, po veçanërisht në festa të ndryshme, sidomos të Djelën e Pashkës.

Njeriu nosta panden se lodrat e sipërme